
REFERATE E KUMTESA

ILIRJANA NANO**MARRËVESHJA SI BURIM I SË DREJTËS
NË PASHALLËKUN E JANINËS****Hyrje**

E drejta në pashallëkun e Janinës, sikundër edhe në pjesë të tjera të Perandorisë Osmane nuk ishte një e drejtë e sanksionuar si një e vetme dhe e zbatueshme në mënyrë unike në gjithë territoret e saj. Në këtë njësi administrative të Perandorisë kanë vepruar paralelisht disa sisteme diverse të së drejtës dhe secili prej tyre kishte burimet e veta, origjinën historike, bazën sociale dhe traditën morale ku ishte kultivuar dhe vazhdonte të ruhej, të cilat meritojnë një analizë të hollësishme për të kuptuar jo vetëm mënyrën e organizimit dhe funksionimit shtetëror, por edhe mënyrën e rregullimit të marrëdhënieve të ndryshme shoqërore dhe të aplikimit të këtyre sistemeve ligjore, të cilat dilnin herë herë jashtë standardit institucional që aplikohej prej perandorisë në juridiksionin e kufijve politikë të saj.

Nga një analizë e hollësishme e burimeve historike, të cilat përfshijnë gjetje të ndryshme dokumentare, studime me karakter shkencor, monografi lidhur me organizimin shtetëror dhe të drejtën, hulumtime në këto fusha, histori të ndryshme të shkruara nga studiues bashkëkohës të Ali Pashës apo të mëvonshëm, nga monografi dhe veçanërisht nga dokumentat e Arkivit të Ali Pashës, mund të tërhiqen disa konkluzione lidhur me këtë fushë me mjaft interes, e cila në thelb formatonte vetë natyrën e shtetit (pashallëkut), karakterin e tij, politikën e brendshme, rregullimet me karakter ekonomik madje edhe politikën e jashtme. Në Arkivin e Ali Pashës gjenden edhe shumë dokumente që hedhin dritë mbi sistemet e të drejtës që vepronin në këtë pashallëk.¹

¹ Arkivi Ali Pasha është një fond prej rreth 1500 dokumentesh të botuara në katër vëllime në Athinë në harkun kohor 2007-2009. Ky fond është nxjerrë nga koleksioni J. Hoxhi i Bibliotekës Genadio të Shkollës Amerikane të Athinës. Ai është përpunuar nga një grup studiuesish të Institutit të Kërkimeve Neohelenike nën drejtimin e historianit Vasilis Panajotopoulos. Konsiderohet sot si një burim mjaft i rëndësishëm

Së pari, **sistemi i të drejtës osmane** është natyrisht sistemi i cili vepronte dhe rregullonte pjesën më të madhe të marrëdhënieve juridike: (administrative, civile, penale, publike, pasurore,) në Pashallëkun e Janinës si pjesë e Perandorisë Osmane. Ky sistem normash mund të ndahet në dy grupe të mëdha:

- Nga një anë Sheriati si “ligji i shenjtë” i cili nënkupton tërësinë e normave juridike të nxjerra nga burimet themelore islame dhe me përprjekjet intelektuale të juristëve osmanë² (në të përmbliidhen norma kryesisht me karakter fetar).

- Nga ana tjetër e drejta pozitive e shtetit osman e krijuar si një tërësi aktesh juridike të nxjerra nga sulltanët përgjatë gjithë historisë së Perandorisë Osmane dhe që përfaqësohej kryesisht nga Kanunametë.³

Së dyti, **sistemi i normave të së drejtës zakonore** i cili ka vepruar shumë më herët se krijimi dhe zhvillimi i Pashallëkut të Janinës nën pushtetin e Ali Pashës dhe ka vazhduar të rregullojë marrëdhëniet mes njerëzve edhe pas rënies së pashallëkut.⁴

Së treti, **sistemi i normave juridike të krijuara nga Pashai i Janinës (e drejta pozitive)** dhe të detyrueshme për t’u zbatuar brenda Pashallëkut.

Së katërti, sistemi i normave të së drejtës fetare (jomuslimane) i cili përfshin disa sisteme sipas besimit fetar të popullsisë të pashallëkut. Këtu mund të flitet për norma dhe të drejtën kishtarë e cila rregullon marrëdhëniet brenda komunitetit ortodoks grek dhe shqiptar të pashallëkut. Nga ana tjetër në pashallëkun e Janinës vërehet një komunitet i konsiderueshëm hebre, i cili zbatonte brenda vetes normat e tij fetare. Është për t’u theksuar se ky fakt, pra ushtrimi i lirshëm i besimeve

për studimin e periudhës së zhvillimit të Pashallëkut të Janinës nën pushtetin e Ali Pashës. Në këtë artikull janë përdorur disa dokumenta të këtij arkivi në funksion të trajtimit të temës.

² Fikret Karçiq, *Historia e së drejtës së Sheriatit*, Prizren: 1994, f. 14.

³ Fatmir Sejdiu, Hilmi Ismaili, *Histori e Përgjithshme e shtetit dhe të drejtës*, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë: 2000, f. 276-277.

⁴ Sipas studiuesit Dritan Egro në veprën *Ligji osman ndër shqiptarët e mesjetës së vonë*, “...kanuni osman, rëndom, iu drejtua normave, rregullave ose praktikave fiskale, të cilat dilnin jashtë kuadrit të parashikuar në ligjin islam. Osmanët pranuan të marrin përkohësisht ose të bënin përgjithmonë të tyren ato aspekte të ligjeve dhe praktikave juridike ekzistuese, të cilat nuk binin ndesh me normat bazë të sundimit osman...”. Ky vlerësim i paraqitur në këtë studim, konfirmon edhe njëherë idenë e veprimit të normave dhe sistemeve të tjera juridike, veç atij osman në territoret e Perandorisë.

të ndryshme fetare dhe respektimi i normave dhe institucioneve të besimeve të ndryshme nga ai islam kërkon një studim më vete.

Burimet e së drejtës pozitive

Në radhën e burimeve të së drejtës pozitive të krijuar nga Ali Pashë Tepelena, një gjetje mjaft e rëndësishme është ajo e studiueses Arta Mandro-Balili në studimin monografik: *Pashallëqet feudale shqiptare në këndvështrimin e shtetit dhe të së drejtës*. Në këtë monografi identifikohen si burim i së drejtës pozitive të krijuar nga pashallarët shqiptarë, Bushatllinjët e Shkodrës dhe Ali Pashë Tepelena, bujurditë.⁵

Në fakt, bujurditë të cilat përdoren në dy pashallëqet shqiptare dhe veçanërisht në Pashallëkun e Janinës, nuk mund të konsiderohen si burime origjinale të së drejtës. Ato ishin një mjet për të shprehur dhe realizuar pushtetin e autoriteteve të provincave osmane të lejuar nga Porta e Lartë. Gjithsesi ato renditen në radhën e burimeve të së drejtës pozitive të aplikuar nga pashallarët vendas.

Me botimin e disa vëllimeve të “Arkivit të Ali Pashës”, çdo lexues, por veçanërisht lexuesi i specializuar jurist ka mundësinë të eksplorojë brenda 1500 dokumenteve, mes të cilave gjenden edhe shumë akte juridike me objekt dhe karakter të ndryshëm.

Këto dokumente, të cilat veç të tjerash dëshmojnë edhe për organizimin e kancelarisë në Pashallëkun e Janinës, përmbajnë material të shumtë mbi të cilin mund të bëhen vlerësime dhe të jepen gjykime lidhur me jetën sociale në pashallëk, atë politike, fetare dhe ushtarake, por veçanërisht edhe për mënyrën e rregullimit juridik të disa llojeve të marrëdhënieve shoqërore.

Në radhën e këtyre dokumenteve të bien në sy një numër relativisht i madh marrëveshjesh.

Marrëveshja konsiderohet si burim mjaft i rëndësishëm i të drejtës, jo vetëm i asaj ndërkombëtare, por edhe për disa degë të caktuara të së drejtës së brendshme. Në mesjetë, shtetet feudale nuk kishin në përgjithësi një kushtetutë të shkruar dhe rendi shtetëror i vendeve feudale

⁵ Arta Mandro-Balili, *Pashallëqet feudale shqiptare në këndvështrimin e shtetit dhe të së drejtës* (Rasti i Pashallëkut të Shkodrës dhe Pashallëkut të Janinës), Tiranë: Mediaprint, 2008, f. 188.

përcaktohej nga marrëveshje të çdo lloji të mbretërve, princërve dhe vasalëve të tyre.⁶

Si shembull tipik i këtyre lloj marrëveshjeve me karakter kushtetues në mesjetë përmendet “Magna Charta Libertatum” (Karta e Madhe e Lirive), nënshkruar më 12 qershor 1215 nga Mbreti i Anglisë, Johani pa Tokë dhe një përfaqësi e baronëve anglezë. Si e tillë, Magna Charta Libertatum, konsiderohet model i parë i kartës kushtetuese.⁷

Në Pashallëkun e Janinës, i cili edhe pse administrativisht ishte pjesë e Perandorisë Osmane, janë nënshkruar dhe aplikuar disa lloje marrëveshjesh me karakter të ndryshëm. Është i njohur fakti (dhe nëpërmjet dokumentave që do të renditen më poshtë konfirmohet edhe njëherë) që Pashai i Janinës ndërmoi hapa konkretë drejt shkëputjes nga Perandoria Osmane. Kjo tendencë e shkëputjes dhe pavarësimit reflektohet edhe në fushën e së drejtës duke hartuar akte në të cilat Ali Pasha shfaqet si një subjekt dhe autoritet me të drejta dhe fuqi ligjhartuese, dhe vepron si i tillë deri në fillimet e viteve 1822, kohë në të cilën ndëshkohet përfundimisht nga Sulltani.

Duke iu referuar disa prej marrëveshjeve të panjohura më parë, por me mjaft interes për t’u bërë prezente, do të rendisnim këtu disa prej tyre duke i klasifikuar si:

- Marrëveshje me karakter të brendshëm
- Marrëveshje me karakter ndërkombëtar

Marrëveshjet e brendshme

Marrëveshjet me karakter të brendshëm kanë tipologji të ndryshme nisur nga subjektet (palët), objekti i marrëveshjes dhe të drejtat dhe detyrimet që i përkisnin secilës nga palët nënshkruese. Më karakteristike janë disa prej tyre si më poshtë:

- Marrëveshje mes Pashallëkut të Janinës dhe pashallëqeve të tjera shqiptare. Në radhën e dokumenteve të gjetura rishtazi në “Arkivin e Ali Pashës” gjenden tre marrëveshje të nënshkruara mes Pashallëkut të Janinës dhe Pashallëkut të Beratit, ato i takojnë vitit 1809 dhe titullohen “Marrëveshje paqeje dhe mirëkuptimi”, e në thelb përcaktojnë kushte për të shmangur dhe ndërprerë konfliktet e deriatëhershme mes dy

⁶ Luan Omari, *Parime dhe institucione të së drejtës publike*, Tiranë: Elena Gjika, 2006, f. 316.

⁷ Aurela Anastasi, *Historia e Institucioneve*, Tiranë: Dajti 2000, 2011, f. 146.

pashallëqeve fqinjë, detyrimet e secilës palë për shmangien e tensioneve, dorëzimin e pjesëve të ndryshme të territoreve të pretenduara nga njëra prej palëve në konflikt, sanksionet në rastet e mosrespektimit të kushteve të parashikuara në marrëveshje, etj.

- Marrëveshje mes Pashait të Janinës dhe krahinave të ndryshme të pashallëkut të përfaqësuar nga krerët e tyre, për t'u vënë në shërbim të Ali Pashës dhe duke pranuar juridiksionin e tij mbi to. (Të tilla janë ato të nënshkruara në vitin 1802 mes Ali Pashës dhe parisë së Çamërisë, mes Ali Pashës dhe krahinës së Himarës).

- Marrëveshje mes fshatrave apo krahinave të ndryshme të Pashallëkut mes njëra tjetrës të cilat në kushtet e konflikteve mes tyre, marrin titullin "Marrëveshje paqeje dhe bashkëpunimi". Në këto të fundit, në jo pak raste, Ali Pasha dhe përfaqësuesit e tij dalin në rolin e ndërmjetësit në hartimin dhe nënshkrimin e tyre. Parë nën një këndvështrim tjetër, roli i Ali Pashës në hartimin dhe nënshkrimin e këtyre marrëveshjeve, mund të konsiderohet nga pikëpamja juridike si shprehje dhe veprim i një instituti shumë të rëndësishëm që sot përdoret për zgjidhjen e konflikteve siç është ndërmjetësimi (sot ndërmjetësimi konsiderohet si një nga mjetet më efikase të zgjidhjes së konflikteve ose mënyrë alternative, pa konsumuar procedurat e gjata dhe të mundimshme gjyqësore).

Në këto marrëveshje mund të dallojmë disa elementë të cilat i gjejmë edhe sot në akte të tilla juridike:

1. Palët (subjektet)
2. Objekti i marrëveshjes (ajo për të cilën kanë rënë dakord palët)
3. Të drejtat dhe detyrimet e palëve
4. Afatet
5. Garancitë e realizimit të marrëveshjes
6. Mënyra e zgjidhjes së problemeve që mund të lindin gjatë zbatimit të marrëveshjes

Këto elementë sigurisht që nuk gjenden në të gjitha këto dokumente, më së shumti gjenden në akte të cilat kanë karakterin e një kontrate civile, ndërsa në raste të tjera marrëveshja ka edhe karakter deklarativ.

Në dokumentin e mëposhtëm kemi të bëjmë me një vullnet të shprehur të rajave të Paramithisë të cilët deklarojnë se njohin për zot të tyre Ali Pashën dhe përcaktojnë edhe detyrimet ndaj tij. Nga ana tjetër ata theksojnë edhe detyrimet e "zotit" të tyre Ali Pasha *'të na ndërtojë shtëpi, të na ruajë nga prapësitë'*:

“Sot, ne rajatë, kudo që ndodhemi në kasabanë e Paramithisë, të vegjël dhe të mëdhej, bëjmë me dije se me dëshirën dhe vullnetin tonë bëhemi raja dhe çifçinj të Madhërisë, Vezirit Ali Pasha për shekuj dhe përherë pasi ishim pa zot dhe pa shtëpi, të strehuar me qira. Ai të na ndërtojë shtëpi, të na ruajë nga prapësitë dhe ne t’i japim atij çdo vit pesëmijë (5.000) grosh. Pra, pesëmijë do të jetë detyrimi ynë, haraçi ynë gjer në vdekje nga koha e martesës dhe nuk do të jetë: diku në Paramithi ka zotëri, dhe diku jo, për të mos dhënë detyrime. Kështu detyrohemi përpara Madhërisë vezir efendi pesë mijë grosh, duke provuar vërtetësinë me dokumentin e shkruar, për sa raja gjenden brenda në Paramithi; dhe të tjerë zotër të rajave në Paramithi nuk do ketë; Kushdo qoftë raja që gjendet këtu, i madh, i vogël do të jemi çifçinj të vezirit Ali Pasha;

E shkrova unë Miço Hasomeri

Dhe e vërtetojmë; unë Miçi Shamaiti shkruaj dhe vërtetoj

Nasi Joto – vërtetoj Nano Logothesi vërtetoj

Nasi Zafiri vërtetoj Kolo Radho vërtetoj

Zoi Paçavelo vërtetoj Jani Miço vërtetoj

Dhimitri Soma vërtetoj Joti Kiçaqi vërtetoj

Dhimitraq Llambro vërtetoj Anastas Gjeorgjiu vërtetoj

Anastas Tafili vërtetoj Kola i Miços vërtetoj

Anagnos Samandi Paskua dhe Jani djemtë e Shushos vërt

Të tjerë raja që mungojnë dhe që gjenden në Paramithi, të vegjël dhe të madhej bëhen çifçinj të Vezir Ali Pashës dhe vërtetojmë sa më poshtë:

(Në krah)

Pano i Masagës, Ibrahim Nina, Mosa Tusofi, Dhimitër Logothesi, Jani Miçi

Dëshmoj Dëshmoj Dëshmoj Dëshmoj Dëshmoj⁸

Nëse bëjmë një analizë më të thelluar të kësaj marrëveshjeje, ajo rezulton një normë e cila rregullon një marrëdhënie të rëndësishme shoqërore në feudalizëm, pikërisht marrëdhënien feudale mes çifligarit dhe çifçinjve. Është një marrëdhënie që ka karakter ekonomik në dukje,

⁸ Βασιλης Παναγιωτοπουλος, *Αρχαιο Αλι Πασα*, Συλλογης Ι. Χοτζις, Γενναδειου Βιβλιοθηκης της Αμερικανικης Σχολις Αθηνων Ινστιτουτο Νεοελληνικων Ερευνων, Αθινα: 2007 Τομος Β’ (491), σελιδα 88, 89, 90 (Vasilis Panaiotopoulos, *Arkivi Ali Pasha*, Koleksioni J. Hoxhi i Bibliotekës Genadio të Shkollës Amerikane të Athinës., Institutit i Kërkimeve Neohelenike, Athinë: 2007, vëll. 2, f. 88, 89, 90).

pasi lidhet me detyrimet financiare të fshatarëve të Paramithisë ndaj çifligarit të tyre Ali Pasha, por më tej akoma ajo ka edhe karakter politik. Nëpërmjet saj fshatarët e Paramithisë njohin si zot të tyre Vezirin e Janinës, njohje kjo kolektive “*ne rajatë, kudo që ndodhemi në kasabanë e Paramithisë, të vegjël dhe të mëdhenj*” dhe nga ana tjetër fshatarët njohin në mënyrë ekskluzive një zot të vetëm “*dhe të tjerë zotër të rajave në Paramithi nuk do ketë*”.

Nëse flasim për afatin e kësaj marrëveshjeje, ai lidhet me karakteristikat e detyrimit të çifçinjve. Bëhet fjalë për një lloj takse të njohur siç është haraçi dhe me faktin që ajo aplikohet për meshkujt e martuar.

Përgjithësisht, në Perandorinë Osmane, numri dhe sasia e taksave që paguante një fshatar raja, varej nga dy elementë:

- Sasia e tokës, e cila varionte në varësi të kushteve të relievit, dhe
- Statusi i tij civil (beqar/i martuar)⁹

Haraçi, kjo taksë për meshkujt e martuar kishte dy momente kohore brenda të cilës aplikohesh. Momenti i parë, nga i cili fillonte detyrimi, ishte martesja dhe pagesa e haraçit vazhdonte për gjithë jetën e përfundonte me vdekjen e rajasë “*haraçi ynë gjer në vdekje nga koha e martesës*”.

Mes elementëve të tjerë të marrëveshjeve siç u theksua më sipër janë edhe garancia për realizimin e tyre. Edhe ky element nuk gjendet në të gjitha marrëveshjet që na paraqiten në “Arkivin e Ali Pashës”.

Le t’i referohemi një tjetër marrëveshjeje e cila titullohet “Marrëveshje paqeje dhe bashkëpunimi”. Ajo është lidhur midis Ali Pashës dhe agallarëve të Margaritit në Çamëri.¹⁰

Në paragrafët e këtij dokumenti gjenden elementë të metodologjisë juridike mesjetare, siç është praktika e pengjeve, e cila aplikohet si mjet garancie për respektimin e kërkesave të parashikuara në “marrëveshje”.¹¹

⁹ Dritan Egro, *Ligji osman ndër shqiptarët e mesjetës së vonë*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: Kristalina-KH, 2012, f. 27.

¹⁰ Βασιλης Παναγιωτοπουλος, *Αρχαιο Αλι Πασα*, Συλλογης Ι. Χοτζις Γενναδειου Βιβλιοθηκης της Αμερικανικης Σχολις Αθηνων Ινστιτουτο Νεοελληνικων Ερευνων, Αθινα: 2007, Τομος Γ’ (1406), σελιδα 616-620 (Vasilis. Panaiotopoulos, *Arkivi Ali Pasha*, Koleksioni J. Hoxhi i Bibliotekës Genadio të Shkollës Amerikane të Athinës, Instituti i Kërkimeve Neohelenike, Athinë: 2007, vëll. 3, f. 616-620).

¹¹ Irakli Koçollari, “Marrëveshje dhe akte ligjore të panjohura të hartuara nga Ali Pasha”, botuar në revistën *Tribunë Juridike*, nr. 84. Luarasi University Press, Tiranë: 2010, f. 130.

Pashai ka kërkuar nga margaritasit pengje prej çdo familjeje, të cilët do të mbaheshin në Janinë për aq sa do të ishte kohëzgjatja e “Marrëveshjes” apo siç thuhet në dokument, gjersa të vërtetohet se ata janë bindur të respektojnë vullnetin e pashait.¹²

Marrëveshjet ndërkombëtare

Marrëveshje me karakter ndërkombëtar janë ato të negociuara dhe disa prej tyre edhe të lidhura mes Pashallëkut të Janinës dhe disa shteteve europiane si Ruisë, Anglisë, Francës etj., të cilat i takojnë fondit të akteve juridike të së Drejtës Ndërkombëtare. Në këto marrëveshje Ali Pasha dhe Pashallëku i Janinës dalin si subjekte të pavarura në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe kërkojnë reciprocitet në raport me palët në këto marrëdhënie.

Gjatë gjithë periudhës 35 vjeçare të sundimit të tij (1787-1822) Ali Pasha krijoi dhe mbajti marrëdhënie me të gjitha shtetet dhe fuqitë më të mëdha të kohës, me Anglinë, Rusinë, Francën, Austrinë dhe në mënyrë konstante edhe me Rusinë.

Marrëdhëniet me këto shtete ishin në interes të përbashkët. Duke parë fuqizimin e vazhdueshëm të pushtetit të pashait, rritjen numerike dhe territoriale të pashallëkut, prirjet dhe tendencën e Aliut për t’u shpëputur sa më shumë dhe sa më shpejt nga Porta e Lartë, shtetet më të fuqishme europiane nuk vonuan të dërgojnë emisarët e tyre në Janinë dhe në qytete të tjera të pashallëkut.

Janina, kryeqyteti i Pashallëkut, u shndërrua në një qendër të rëndësishme diplomatike, jo vetëm në Ballkan, por edhe në Evropë. Të quajturat “fuqitë e mëdha” të kohës (Franca, Anglia, Rusia) hapën konsullatat e tyre në Janinë dhe përfaqësi në qytete të tjera të pashallëkut. Vetë (Ali Pasha) organizon shërbimin e tij të jashtëm si një “ministri të jashtëm” të vërtetë.¹³

Veprimet energjike të Ali Pashë Tepelenës në drejtim të forcimit të pashallëkut, treguan qartë prirjen e tij separatiste për të krijuar një entitet shtetëror autonom e ndoshta edhe të pavarur nga Porta.¹⁴

¹² Po aty, f. 131.

¹³ Αναστασιος Παπαstavros, *Ali Pasha nga hajdut, hegjemon* (Anastasios Papastavros, *Ali Pasha nga hajdut, hegjemon*), vol. I, Botimet Apeirotan, 2013, f. 65

¹⁴ Ferit Duka, *Shekujt osmanë në hapësirën shqiptare* (studime dhe dokumente), Tiranë: UET Press, 2009, f. 391.

Vendosja e lidhjeve dhe marrëdhënieve të fshehta dhe të hapura u bë në kundërshtim me parimet e diplomacisë osmane.

Deri në fund të shek. XVIII, diplomacia osmane nuk perceptohej e njëjtë me atë të shteteve Perëndimore. Shteti osman nuk dërgonte përfaqësues të vet në shtete të tjera dhe nuk mbante përfaqësues diplomatikë të shteteve të huaja. Një kthesë u shënuar në diplomacinë e shtetit osman në vitin 1793, kur u vendos që të dërgoheshin përfaqësues të përhershëm diplomatikë në të gjitha shtetet kryesore europiane si dhe të zgjerohesh personeli i ambasadave, edhe me personel jomysliman që dinte dhe njihnte mirë gjuhët e huaja perëndimore. Në fund të shekullit XVIII shteti osman mbante lidhje diplomatike me gati çdo shtet të krishterë perëndimor, duke përfshirë Anglinë, Francën, Rusinë, Austrinë, Spanjën, Prusinë, Danimarkën, Hollandën, Suedinë, Poloninë, Venedikun dhe Dy Siçilitë. Deri në intensifikimin e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe përpunimin e një diplomacie moderne, shteti osman i konsideronte përfaqësuesit e shteteve të huaja në Stamboll apo në rrugët për në Stamboll, si mysafirë që emigronin nën mbrojtjen e tij. Shteti osman ishte i përgjegjshëm për sigurinë dhe paprekshmërinë e tyre, ndërkohë që kërkonte ekuilibër, barazi dhe reciprocitet në diplomaci. Reciprociteti ishte ndër parimet më të rëndësishme të diplomacisë së shtetit osman.¹⁵

Vetëm në vitin 1837 nisi punë Ministria e Punëve të Jashtme (Harexhije Nezareti). Deri në këtë kohë nuk ekzistonte një institucion i specializuar dhe ngarkuar që të përcaktonte dhe të drejtonte drejtpërdrejt marrëdhëniet ndërkombëtare në shtetin osman.¹⁶

Në këtë këndvështrim, politika e jashtme e Perandorisë Osmane ishte ekskluzivitet i pushtetit qendror dhe jo i njësive administrative të tij siç ishin pashallëqet. Në kundërshtim me këtë parim dhe praktikë të konsoliduar prej shekujsh, Pashai i Janinës anashkaloi haptaz Portën e Lartë dhe vendosi lidhje të drejtpërdrejta me fuqitë europiane të cilat i shihte si aleate të mundshme për përmbushjen e qëllimit të tij të shfaqur shumë herët: shkëputjen nga Perandoria Osmane dhe krijimin e një shteti të pavarur.

¹⁵ Research Centre for Islamic History, Art and Culture; *Historia e Shtetit, Shoqërisë dhe Qytetërimit Osman*, vëll. I, Tiranë: AIITC, 2009, f. 208.

¹⁶ *Po aty*.

Projekt marrëveshje mes Ali Pashës dhe Ruisë

Në fondin e marrëveshjeve me karakter ndërkombëtar vlen të përmendet një e tillë shumë e rëndësishme. Është për t'u theksuar se dokumenti që sillet më poshtë mbeti në kuadër të projektit. Ai nuk arriti të nënshkruhej asnjëherë, për shkaqe që nuk janë objekt i këtij punimi. Bëhet fjalë për një projekt marrëveshje mes Ali Pashës dhe Ruisë.

Është vendi për të theksuar që para se të kthenin vëmendjen drejt Pashallëkut të Janinës, rusët, së bashku me austriakët kishin bërë më parë përpjekje për të krijuar aleancë me Mahmut Bushatlliun, Pashain e Shkodrës. Këto përpjekje rezultuan të pasuksesshme dhe dështuan si pasojë e një incidenti të ndodhur në liqenin e Shkodrës ku u vra këshilltari ushtarak austriak De Broniar. Pas këtij incidenti me Mahmut Pashë Bushatlliun gjatë periudhës së Luftës Ruso-Turke, Shqipëria e Jugut dhe Epiri, u kthyen në epiqendër të aktivitetit politik të Ruisë në Ballkanin Perëndimor.¹⁷

Studiuesi rus Gregori Arsh, në veprën e tij: *Shqipëria dhe Epiri në fund të shekullit XVIII dhe fillim të shekullit XIX, pashallëqet lindore shqiptare të Perandorisë Osmane*, botuar në Moskë në vitin 1963, përkthyer dhe botuar në greqisht në vitin 1994, duke folur për marrëdhëniet mes Perandorisë Ruse dhe Ali Pashës, na sjell një dokument shumë të rëndësishëm i cili hedh dritë mbi tendencat dhe përpjekjet konkrete të Pashait të Janinës për t'u shkëputur nga Perandoria Osmane.

Teksti i marrëveshjes më poshtë është përkthyer nga autorja e këtij punimi sipas botimit në greqisht të kësaj vepre.¹⁸

¹⁷ Γκριγορι Λ. Αρς, *Η Ρωσία και τα πασαλίκια Αλβανίας και Ηπειρου, 1759-1831. Εγγράφα ρωσικών αρχείων. Ινστιτούτο Νεοελληνικών σπουδών, Ινστιτούτο σλαβικών σπουδών. Ακαδημία Επιστημών Ρωσίας, Αθήνα: 2008, σελίδα 19-21.* (Gregori L. Arsh, *Rusia dhe pashallëqet e Shqipërisë dhe Epirit, 1751- 1831. Dokumenta të arkivave ruse, Instituti i studimeve neohelenike, Instituti i Studimeve Sllave, Akademia e shkencave të Ruisë, Athinë 2008, f. 19-21).*

¹⁸ Kjo marrëveshje e përkthyer në shqip është prezantuar së pari në Konferencën e Dytë Ndërkombëtare Shkencore “*The State, Society and Law: Human Rights Challenges in Albania*”, organizuar nga Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës dhe Fakulteti i Drejtësisë i Universitetit “Luarasi” Tiranë, në mars 2013, si pjesë e referatit të mbajtur nga autorja e këtij punimi me temë: “Prirjet e Ali Pashës për shkëputje nga Perandoria Osmane dhe marrëdhëniet e tij me Rusinë, sipas arkivave ruse”, Tiranë: Dita 2000, 2013, f. 17.

Ali Pasha deklaron se është i gatshëm të bëjë aleancë me Rusinë dhe të provokojë në territorin e tij, së bashku me grekët një diversion në dobi të saj (Rusisë- I.N.). Dëshiron:

1. *Garancinë që ai vetë, po aq dhe familja e tij dhe të gjithë myslimanët në varësi të tij, të gëzojnë lirinë e plotë të besimit.*

2. *Të përcaktohen gjatë negociatave zonat që do të mbeten pronë e tij dhe në të cilat do të njihet si zot. Nga ana e tij merr përsipër të mos rëndojë me taksa banorët grekë më tepër se ata turq. Këto taksa mund të përcaktohen gjatë negociatave në përputhje me parimet e të drejtës dhe maturisë.*

3. *Grekët, në mënyrë të barabartë me turqit, do të mund të marrin të gjithë gradat dhe titujt, si ato politike, edhe ato ushtarake, në varësi të aftësive të tyre personale.*

4. *Ligjet dhe urdhëresat do të përshtaten në gjuhën greke, pasi ajo është më e përhapur në territoret ku pashai dëshiron të ushtrohet pushteti i tij.*

5. *Grekët do të vazhdojnë të mbeten nën kujdesin rus, por pa patur të drejtën t'u drejtohen gjykatave ruse. Ndërkohë, Oborri rus do të mund të kërkojë nga Pashai një drejtësi më të mëshirshme në rast se ata (grekët – I.N.) konsiderojnë që janë shtypur apo fyer.*

6. *Pavarësisht taksave, pashai merr përsipër të mbajë me shpenzimet e veta një regjiment të përbërë nga grekë dhe turq, që do të jetë gjithmonë në gatishmëri. Kërkon gjithashtu, t'i jepet grada e kolonelit njërit prej djemve të tij, duke preferuar ta dërgojë menjëherë në Rusi për t'u specializuar në mënyrë që të jetë që në fillim të çështjes një lloj garancie për besnikërinë dhe përkushtimin e babait të tij.*

7. *Rusia nga ana e saj do të japë numrin e caktuar nga bisedimet, të topave dhe granatave dhe një shumë të hollash, me anë të së cilës do të ndihmojë në mbajtjen e ushtrisë së Tij deri sa gjithçka të jetë organizuar (periudha kohore llogaritet në 6 muaj). Pashai do të jetë i detyruar të kthejë kapitalin dhe interesat në kohën e përcaktuar.*

8. *Rusia detyrohet të mbajë një trupë ushtarake të rregullt si dhe të formojë një të dytë të përbërë nga grekë, për të ndihmuar pashain dukshëm para të gjithëve, në mënyrë që të largojë komandantët turq të prirur për keq dhe të shuajë dyshimet e atyre, të cilët pashai beson se do ta ndjekin. Trupat e mësipërme do t'i mbajë Rusia dhe pashai nuk do të ketë detyrimin të rimbursojë shpenzimet.*

Nëse çështja, pas lidhjes së marrëveshjes, nuk do të arrijë suksesin e kërkuar, atëherë Rusia do të jetë e detyruar ta konsiderojë Ali Pashën aleat të saj, të varur prej saj, dhe duhet të përdorë në kohë paqeje, ndikimin e saj pranë Portës për ta mbrojtur dhe për ta ndihmuar në mënyrë konkrete në rast se sulltani përdor kundër tij forcat e veta ushtarake.¹⁹

Si çdo marrëveshje e kësaj natyre, edhe ajo është negociuar më parë. Këto negociata kishin filluar në qershor 1791 mes përfaqësuesve të Ali Pashës dhe Komandantit V.S.Tamara lidhur me shkëputjen e Aliut nga Perandoria Osmane dhe vendosjen e tij nën protektoratin e Ruisë. Përfaqësuesit e prokuruar nga Pashai i Janinës paraqitën një projekt marrëveshje me kushtet e shkëputjes si më sipër.²⁰

Negociatat mes përfaqësuesve të Ruisë dhe atyre të Ali Pashës, të cilat filluan në një nga ishujt e Jonit, Kálamos, u zhvendosën në brigjet e Dúnavit, ku Ali Pasha me trupat e tij iu bashkuan ushtrisë së Vezirit të Madh. Në gusht 1791, gjenerali i shquar rus Potjémkin, takoi në repartin e tij, një përfaqësues, njeri të besuar të Ali Pashës, Mehmet Efendi Bulçí.

Ky njeri i Ali Pashës në këtë periudhë përfaqëson një funksionar të lartë të tij. Mehmet Efendiu qëndronte në krye të Divanit, një organ ndihmës i Ali Pashës, të cilit Aliu i kishte dhënë atributet e qeverisë.²¹ Pra niveli i përfaqësimit nga ana e Ali Pashës ishte realisht shumë i lartë. Ai dërgon në bisedime me gjeneralin rus vetë “kryeministrin” e tij. Madje, në disa raste, Ali Pasha është vetë i pranishëm në bisedime me përfaqësuesit ushtarakë dhe diplomatikë rusë dhe zhvillon me ta biseda dhe negociata.

Në letrën e tij personale që mban datën 24 gusht (4 shtator) 1791, Potjemkini e siguron Aliun për gatishmërinë e tij për të vazhduar kontaktet me të dhe se do të përmbushte detyrimet e tij : “...u kënaqa sinqerisht nga gjithçka, sa më kumtoi përfaqësuesi Juaj, dhe në të

¹⁹ Γκριγορι Λ. Αρς, *Η Αλβανία και Η Ηπειρος στα τέλη του ΙΗ' και αρχές του ΙΘ' αιώνα. Τα Δυτικοαλβανικά Πασαλίκια της Οθωμανικής Αυτοκρατορίας*, Guttenberg, Αθήνα: 1994, σελίδα 163, 164. (Gregori L. Arsh, *Shqipëria dhe Epiri në fund të shekullit të XVIII dhe fillim të shekullit XIX. Pashallëqet Lindore shqiptare të Perandorisë Osmane*), Athinë: Guttenberg, 1994, f. 163-164.

²⁰ *Po aty.*

²¹ *Historia e Shqipërisë, Vëll. I*, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe Gjuhësisë, Tiranë 1959, f. 464.

*ardhmen do të shihni që do të përpiqem vazhdimisht të dëshmoj realisht ndjenjat e mia...*²²

Lidhur me karakterin e projekt marrëveshjes së prezantuar më sipër, disa studiues e konsiderojnë atë si marrëveshje ushtarake. Për mendimin tim, ky projekt është më tepër. Ai ka karakter të mirëfilltë politik dhe aspekti ushtarak është vetëm një prej disa aspekteve të tij. Edhe pse i diktuar nga interesat e dy palëve: Ali Pashës dhe Perandorisë Ruse në kushtet e armiqësisë me Perandorinë Osmane, armiqësi kjo e dukshme dhe e deklaruar nga ana e Rusisë gjatë disa luftrave ruso-turke, e fshehtë dhe e kamufluar nga ana e Ali Pashës, duket që Ali Pasha ka dashur të tejkalojë në kohë, kërkesa dhe detyrime që merr përsipër, situatën që ka bërë të mundur dërgimin e këtij propozimi. Aspekti ushtarak, siç u theksua më sipër, nuk ishte i vetmi. Një tjetër aspekt shumë i rëndësishëm i këtij projekti lidhet me trajtimin ligjor të grekëve që siç dihet përbënin një pjesë të konsiderueshme të popullsisë së Pashallëkut të Janinës dhe nga ana tjetër gëzonin një përkrahje, mbështetje dhe mbrojtje nga Perandoria Ruse nisur edhe nga solidariteti fetar, por jo vetëm. Detyrimet që merr përsipër pashai për trajtimin ligjor të popullsisë greke, duket që nga ana tjetër, si në çdo marrëveshje me karakter juridik, u korrespondojnë të drejtave që Rusia do të kishte mbi popullsinë greke të Pashallëkut, siç përshkruhet në pikën 5 të projektit, ku Perandorisë Ruse i rezervohet e drejta për t'iu drejtuar sistemit të gjykatave të brendshme për të kërkuar “drejtësi më të mëshirshme për grekët”. Parë në këndvështrimin aktual, kjo klauzolë i kapërcen madje të drejtat që shtete të ndryshme në Kushtetutat e sotme i japin vetes për të mbrojtur bashkëkombasit e tyre që jetojnë në shtete të tjera.²³

Përcaktimet si “grekët” dhe “turqit” në këtë propozim, përveç ngjyrimin etnik, kanë edhe atë fetar në kuptimin “ortodoksë” dhe “myslimanë”, pasi popullsia “shqiptare” e pashallëkut ishte më e madhe

²² Αρς Λ. Γκριγκορι, *Η Ρωσία και τα πασαλίκια Αλβανίας και Ηπειρου, 1759-1831. Εγγραφα ρωσικών αρχείων. Ινστιτούτο Νεοελληνικών σπουδών, Ινστιτούτο σλαβικών σπουδών. Ακαδημία Επιστημών Ρωσίας, Αθίνα: 2008, (εγγ.νο. 28), σελίδα 103. (Gregor L. Arsh, *Rusia dhe pashallëqet e Shqipërisë dhe Epirit, 1751- 1831. Dokumenta të arkivave ruse. Instituti i Studimeve Neohelenike, Instituti i Studimeve Sllave, Akademia e Shkencave të Rusisë, Athinë: 2008, dok. nr. 28, f. 103).**

²³ P.sh neni 8/pika 1 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon se “Republika e Shqipërisë mbron të drejtat kombëtare të popullit shqiptar që jeton jashtë kufijve të saj”.

në numër se ajo “greke” dhe nga pikëpamja fetare ajo i përkiste të dy besimeve. Në këtë kuptim, garancia që pashai kërkon për vete, familjen e tij dhe gjithë myslimanët e pashallëkut, për të ushtruar lirisht besimin fetar, është mëse e kuptueshme, në kushtet kur kjo projekt marrëveshje mund të shihet edhe si një marrëdhënie mes Pashallëkut të Janinës me një udhëheqës mysliman dhe Perandorisë Ruse, shtetit më të madh ortodoks të kohës.

Nga sa shihet më sipër, kjo propozim-marrëveshje është tipike si çdo marrëveshje tjetër ndërkombëtare ku prezantohen palët, objekti i saj si dhe të drejtat dhe detyrimet e secilës palë pjesëmarrëse. Gjykimi për formën dhe karakterin e kësaj marrëveshjeje nuk ndryshon edhe pse ajo nuk arriti të nënshkruhej dhe mbeti vetëm një projekt.

Një tjetër projekt marrëveshje me karakter ndërkombëtar është ajo që do të paraqitet më poshtë, e negociuar nga të dërguarit e Ali Pashës dhe përfaqësuesit e qeverisë së Anglisë. Kjo projekt marrëveshje daton në shkurt 1812, rreth 20 vjet më vonë nga projekti me Rusinë. Është e kuptueshme se tendenca e Ali Pashës për të siguruar aleatë të fuqishëm në përpjekjet e tij për t’u shkëputur nga Porta e Lartë, ashtu edhe nuhatja e tij për t’i gjetur këta aleatë tek “armiqtë” e Portës. Pikërisht në periudhën për të cilën po flasim, Anglia ishte fuqia tjetër e madhe evropiane e cila kishte shfaqur interesat e saj për këtë anë të Perandorisë dhe kishte vendosur lidhje të hapura dhe të fshehta me Pashain e Janinës.

Diferenca kaq e madhe në kohë mes përpjekjeve për t’u lidhur dhe për të siguruar aleancë me këto dy fuqi: Rusinë dhe Anglinë buron kryesisht nga fakti që anglezët mbërritën relativisht vonë në raport me rusët në territoret e Pashallëkut të Janinës, ndërkohë që francezët jo vetëm ishin të pranishëm në Pashallëk me përfaqësuesit e tyre diplomatikë, por në këtë kohë (pas vitit 1797 kur u nënshkrua Traktati i Kampo- Formios) zotëronin edhe Korfuzin dhe ishujt e Jonit, quajtur “Republika e shtatë ishujve” .

Veç ishujve të Jonit, francezët morën në zotërim edhe territore bregdetare kontinentale në Ballkanin Perëndimor: Prevezën, Pargën dhe Butrintin, territore këto që përfshiheshin brenda juridiksionit të Pashallëkut të Janinës²⁴.

²⁴ Irakli Koçollari, *Ali Pasha dhe Shqipëria në Arkivat Britanik*, Iceberg Publishing House, Tiranë: 2013, f. 30, referuar G.Vadencourt, *Memoirs on the Jonian Islands*, W. Walton, London: 1815.

Diplomati i parë anglez që mbërrin në Pashallëkun e Janinës është Uilliam Hamilton. Ai vjen në Pashallëk nga Konstandinopoja ku ishte i akredituar, me ftesë të Ali Pashës në vitin 1803. Ndërsa në fillim të vitit 1804, Xhon P. Morier u dërgua me mision në Pashallëqet e Shqipërisë dhe Moresë, nën mbulesën e Konsullit të Përgjithshëm.²⁵

Pra vetëm duke filluar nga viti 1804 mund të flitet për marrëdhënie të rregullta diplomatike të Anglisë me Pashallëkun e Janinës. Duket që Pashai i Janinës nuk ka lënë të kalojë një kohë e gjatë para se të shprehë hapur para përfaqësuesve anglezë ambicjet e tij për t'u shkëputur nga Porta e Lartë. Projekt marrëveshja e mëposhtme është shprehje jo vetëm e tendencës së tij për shkëputje nga Perandoria, por edhe nevojë për të patur një aleat të fuqishëm si Anglia. Referuar arkivave ruse, një pjesë e dokumentave të të cilave janë publikuar nga studiuesi Gregori Arsh, përpjekjet për të patur një aleancë me Rusinë nuk kanë rreshtur deri në fund të jetës së Pashait.

Në rastin e Anglisë, marrëdhëniet kanë qenë të gjithanshme dhe një pjesë e dokumentave të arkivave britanike janë paraqitur në veprën e studiuesit Irakli Koçollari, "Ali Pasha dhe Shqipëria në arkivat britanike".

Mesa duket nga dokumentet që aktualisht janë në dispozicion të studiuesve, vetëm me Francën, këtë fuqi tjetër të madhe të kohës gjatë sundimit të Bonapartit, nuk ka patur prirje të shprehura hapur për të krijuar aleancë kundër Portës apo për të siguruar mbështetje në rast shkëputjeje. Nuk duhet harruar që në fund të shek. XVIII, pra në vitin 1797, francezët tashmë përbënin një rrezik faktik dhe potencial për Pashain duke marrë në zotërim siç u theksua më sipër territore të Pashallëkut dhe territore fqinjë me të. Ishte pra e pranueshme që Ali Pasha të mos besonte, të mos shpresonte, të mos hapej e të mos kërkonte garanci nga francezët. Ardhja e britanikëve në pashallëk ishte një dritë jeshile për të në funksion të interesave të tij tashmë të shprehura hapur për t'u shkëputur nga Porta e Lartë.

Marrëveshja e mëposhtme është publikuar nga Gabriel Remerand në veprën e tij "Ali de Tebelen, Pasha de Janina".

Projekt marrëveshje mes Ali Pashës dhe Anglisë

Në muajin Shkurt (1812) u mësua se Pashai, i cili dëshironte të kishte marrëdhënie të ngushta bashkëpunimi më shumë se çdo herë tjetër

²⁵ Po aty, f. 47.

me anglezët, dërgoi në Maltë dragomanin (sekretarin) e tij Spiro Kolovo, me një korvetë të vjetër franceze që mbante emrin "Orfeu". Këtë anije, tre vite më parë e kishin kapur në luftime forcat ushtarake të Aliut.

Kolovoi do t'i jepte princit – regjent propozimet e shkruara të Ali Pashës për një marrëveshje. Pikat e propozimit që Veziri do t'i parashtronte kabinetit të Sent Xhejmsit ishin:

1. Britania e Madhe të mbronte dhe të siguronte Ali Pashën me familjen e tij nga të gjithë armiqtë e tij, duke i dërguar për këtë qëllim ndihma financiare, armë dhe municione.

2. Një bazë ushtarake detare angleze duhej të survejonte dhe të siguronte brigjet detare shqiptare nga sulmet e mundshme të Zotërisë së Madh (Turqisë) dhe francezët.

3. Në rast të një ekspedite angleze apo ruse kundër Korfuzit, Ali Pasha merrte përsipër të ndihmonte me gjithçka sulmuesit, pavarësisht qëndrimit të qeverisë së tij (Turqisë).²⁶

4. Ai vinte në shërbim të anglezëve njëzetmijë shqiptarë, si dhe do të furnizonte ata (anglezët) me mish dhe lëndë drusore.

5. Përsa kohë Korfuzi do të ishte në duart e francezëve, Ali Pasha merrte përsipër të punonte kundër tyre dhe t'i luftonte ata si armiq, pasi ata përpiqeshin ta diskriminonin atë në Divan dhe tek vetë Sulltani dhe përpiqeshin ta rrëzonin atë.

6. Si shpërblim për shërbimet që do t'u bënte, ai (Ali Pasha) kërkonte nga ana e anglezëve Pargën, Santa Maurën (Agjia Mavrën) Kalamandin, Meganisinë dhe disa ishuj të vegjël që gjendeshin në brigjet shqiptare.

7. Në rast lufte midis Portës së Lartë dhe Anglisë, ose aleatëve të saj, ai merrte përsipër, me gjithë fermanët e shumtë që i ishin dërguar (nga ana e Sulltanit), të pranonte anijet angleze në portet e tij, t'i mbronte, t'i furnizonte me ushqime, me kuaj, me materiale lundrimi dhe gjithçka tjetër ngaburimet e vëndit.²⁷

²⁶ Aso kohe Rusia dhe Britania e Madhe ishin në aleancë. Nga ana tjetër duket qartë që Ali Pasha merr një qëndrim krejt të pavarur në politikën e jashtme, qëndrim i cili vinte ndesh me atë të Perandorisë Osmane, çka tregon faktin se tanimë ai shfaqet si subjekt i pavarur në arenën ndërkombëtare. (Shënim - I.N.)

²⁷ Gabriel Remerand, *Pashai i Janinës*, Tiranë: Globus R, 2004, f. 208.

Edhe pse, siç u theksua më sipër, distanca kohore mes këtyre dy projekt marrëveshjeve është gati 20 vjet, qëndrimi i Ali Pashës në raport me shkëputjen e tij nga Porta e Lartë dhe përpjekjet e tij për të lidhur një aleancë të qëndrueshme me një nga fuqitë që dominonin këtë periudhë, mbeten prapë të njëjta. Në të dy rastet, veç kërkesave që Pashai i Janinës kishte ndaj këtyre fuqive (respektivisht Rusisë dhe Anglisë), ai bujarisht vetëofrohet me shërbime kryesisht ushtarake duke dashur të dëshmojë jo vetëm dëshirën dhe vullnetin e tij, por edhe duke i rritur garancitë për palën tjetër. Sikundër edhe marrëveshja e parë, edhe kjo marrëveshje me Anglinë, mund të shihet në disa këndvështrime dhe merr karakter jo vetëm ushtarak.

Përfundime

Siç u theksua përgjatë këtij artikulli, sistemet e së drejtës në Perandorinë Osmane janë të disa llojeve. Ato përfshijnë si burimin parësor që ishte Ligji i Shenjtë (Sheriati), ashtu edhe burime të krijuara me akte të ndryshme juridike të hartuar nga sulltanë.

Ndryshe nga qeveria qendrore, njësitë administrative, në kuadër të një procesi decentralizimi që po ndodhte, për më tepër edhe në kushtet e tendencave për shkëputje të disa provincave, zhvillojnë dhe zbatojnë edhe burime të tjera të së drejtës.

Sigurisht burimi parësor mbetet po ai, sheriati, por burime të tjera lidhen me aftësinë hartuese e krijuese të normave të reja të cilat shpallen nën autoritetin e pashallarëve të provincave.

Në këto kushte edhe në pashallëkun e Janinës, kemi zhvillimin e disa burimeve të rëndësishme të së drejtës pozitive, mes të cilave bujurditë, të cilat nuk mund të konsiderohen burime origjinale (ekzistojnë edhe në njësi të tjera administrative si atribut i qeveritarëve lokalë) si dhe marrëveshjet.

Lidhur me këto të fundit, ato mund të vlerësohen si origjinale për faktin se është vetë periudha, kushtet historike, ndryshimet e mëdha që po ndodhnin në administrimin e Perandorisë Osmane dhe provincave të saj, tendencat separatiste të Ali Pashës dhe vizioni i tij për krijimin e një shteti të pavarur, të cilat ndikuan në fuqizimin e pushtetit të tij si dhe njohjen brenda dhe jashtë territoreve të pashallëkut si autoriteti i vetëm dhe i plotfuqishëm për të nxjerrë dhe shpallur norma të tilla me karakter juridik.

Anashkalimi, injorimi dhe jo pak herë kundërshtimi i Portës së Lartë dhe fuqisë së saj mbi këtë provincë osmane, dëshmojnë edhe njëherë për shkallën e lartë të kontrollit e të ushtrimit të pushtetit mbi territorin e pashallëkut nga Ali Pasha si autoritet i vetëm dhe i pakundërshtueshëm politik, ushtarak, administrativ dhe ligjor.